



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



### ISLAMIC RELIEF KOSOVA

*Duke u bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Deçanit dhe Islamic Relief Kosova të datës 08/08/2024 me nr të prot: 26142, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Deçanit publikon këtë:*

### **Thirrje për aplikim në “Projektin për Përkrahjen e Fermerëve me Serra 100m<sup>2</sup> për Kultivimin e Perimeve”.**

#### **➤ Kriteret e përgjithshme për aplikim:**

1. Fermeri duhet të jetë qytetar i Komunës së Deçanit;
2. Të posedojë sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e serrës( minimum 0.05 ha ngjitur ose afër pronës ku banon);
3. Të ketë mundësi për ujitje për serrë;
4. Të jetë i/e gatshëm të participojë me 20% të vlerës së përgjithshme të serrës;
5. Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët e as familjarët e ngushtë të fermerëve që kanë qenë përfitues nga “Projekti me tre(3) Kontingjentet me Mëshqerra Barrëse Raca Hollshtajn – Frizis të shpërndara nga Komuna e Deçanit në tri(3) vitet e fundit;
6. Nuk mund të jenë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
7. Përparësi do të kenë fermerët që janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore(dëmtim i serrës) nga era, breshri(dëshmi foto) etj;
8. Në kushte të barabarta përparësi do të kenë fermerët gra që janë nëna vetushqyese, si dhe familjet me fëmijë jetim;
9. Në kushte të barabarta përparësi do të kenë fermerët me kushte të dobëta ekonomike( familjet që nuk kanë të punësuar, rastet sociale etj)
10. Përfituesit nuk kanë të drejtë të shesin apo tjetërsojnë serrën për tre(3) vitet pasuese

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Letërnjoftimi Kopje;
2. Fleta poseduese dhe kopja e planit( prona në emër të fermerit aplikues ose e ndonjërit nga anëtarët e ngushtë në bashkësinë familjare);
3. Aplikacioni i plotësuar nga fermeri aplikues;
4. Certifikata e bashkësisë familjare;
5. Numri Identifikues i Fermerit të Regjistruar NIF

**Vërejtje:**

- Nëse komisioni e parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, aplikuesi(fermeri) është i obliguar t'i sjell ato në afatin e caktuar, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfitues i grantit;
- Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk shqyrtohen dhe eliminohen nga aplikimi.

Afati për aplikim është nga 28/10/24 deri me 11/11/24.

Aplikimi bëhet në zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë nr 35, në katin e tretë në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori i DBPZHR-së në Komunën e Deçanit

RIFAT STOJKAJ

		REPUBLIKË E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA DEÇANIT - DEÇAN MUNICIPALITY	
Niveli i:	Drejtori	Numri i:	36276
Drejtori	Drejtori	Data:	28.10.24
№ i:	08		
№ i:			
№ i:			
DEÇAN DEÇANI			